REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KËSHILLI I MINISTRAVE**
**KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**VENDIM**

Nr. 1, Datë 07.03.2014

**PËR**

**MIRATIMIN NË PARIM TË ZHVILLIMIT TË VIJËS BREGDETARE TË QYTETIT TË VLORËS, SIPAS PROJEKTIT FITUES TË KONKURSIT NDËRKOMBËTAR**

Në mbështetje të neneve 6, 8, 70/8 dhe 70/11 të Ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për Planifikimin e Territorit", i ndryshuar, të VKM-së nr. 502, datë 13.07.2011 "Për Miratimin e Rregullores Uniforme të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, VKM-së nr. 887, datë 03.10.2013 "Për Përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit", me propozimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin në parim të zhvillimit të Vijës Bregdetare të qytetit të Vlorës, sipas projektit fitues të konkursit ndërkombëtar "Vlora Waterfront", përzgjedhur nga Juria e tij më 21.02.2014.

2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është planimetria e projektit fitues të propozuar nga studio XDGA dhe relacioni shpjegues për prezantimin e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Vlorë të ndjekin hartimin e projektit të detajuar për Vijën Bregdetare të qytetit të Vlorës deri në finalizimin e tij, në bashkëpunim me studion fituese XDGA.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT - KËSHILLI I MINISTRAVE

**EDI RAMA**

**ZËVENDËS KRYETARE E KKT**

**Znj. EGLANTINA GJERMENI**

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT

**SEKRETARE E KKT**

**Znj. ADELINA GRECA**

DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT